39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 632-24-5437-5-1-1/C980

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</i>
<i>Përshkrimi i nenit</i>	<i>Neni. Nr.</i>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 37 muaj. Kontraktuesi obligohet që para nënshkrimit të kontratës të bëjë depozitimin e sigurisë së ekzekutimit.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë menjëherë pas nënshkrimit të kontratës sipas urdhërësës me shkrim nga menaxheri i projektit
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë brenda 36 muajve nga nënshkrimi i kontratës.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit

		<p>përfundimtar të Kontratës për ditë.</p> <p>Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.</p>
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit do të caktohet me vendim të ZKA.
		<p>Ky projekt është financim i Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport, bazuar në Memorandumin për bashkëpunim nr1830/2024, dt.04.04.2024, të lidhur në mes Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Komunës së Gjakovës.</p> <p>Zyrtari monitorues I caktuar nga MAPL-ja për këtë projekt, do të bëjë përcjelljen e implementimit të kontratës nga fillimi deri në përfundim të saj dhe në rast se vëren parregullësi apo defekte gjatë realizimit të kontratës njofton menaxhmentin e MKRS-së..</p>
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: nuk është e nevojshme
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 12 muaj pas pranimit të punëve të kryera.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

STADIUMI I QYTETIT NË GJAKOVË
LOKACIONI: GJAKOVË

A	TRIBUNA PERËNDIMORE				
1. PUNËT NDËRTIMORE					
1.0	PUNËT PARAPREGADITORE				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1.1	Rrethimi dhe sigurimi i punishtes me konstruksion metalik dhe llamarinë të zinkuar me lartësi 2 m në tërë perimetrin e caktuar të punishtes dhe shënjëzimi informativ me tabelën informuese me dimensione 1.5x2 m të punuar nga profilet e hekurit dhe llamarina. <u>Dimensionet e shesh ndërtimit: 150x35 m</u>	komplet	1.00	1,000.00 €	1,000.00 €
1.2	Organizimi i punishtes dhe depove, furnizimi me material dhe ndërtimi i rrjetit të përkohshëm të ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit elektrik dhe ndriçimit të kanlierit, vendosja e kontejnerit për zyren e menaxhimit të projektit dhe vendosja e WC kabinave për nevojat e punëtorëve.	komplet	1.00	950.00 €	950.00 €
1.3	Pozicionimi gjeodezik i nevojshem per te gjitha pozicionat dhe shënjëzimi i objektit për ndërtim	komplet	1.00	450.00 €	450.00 €
1.4	Pastrimi i tërësishëm i objektit dhe terrenit rreth objektit pas përfundimit të punimeve nga të gjitha ndërtimet e përkohshme, rrethojat, mbeturinat inerte dhe ambalazhet e pakëtimet e materialeve, etj.	komplet	1.00	950.00 €	950.00 €
1.5	Pastrimi i teresishem i hapësires se ku do te ndërtohet Tribuna perendimore. Pastrimi nenkupton pastrimin nga mbeturinat inerte dhe biologjike te hudhura.Hapësira e cila planifikohet te pastrohet ka dim: 130x35m	komplet	1.00	950.00	950.00
1.6	Demonitim-demolimi i objektit ekzistues te klubit te futbollit "Vllaznimi".Objekti ka siperfaqe te bazes rreth 350m² dhe eshte dykatesh.Eshte relativisht i ri i ndërtuar me material te forte.Objekti eshte i mbuluar me tjegulla. <u>Verejtje: Duhet paraprakisht te behen demontimet e dverve, dritareve, tjegullave, konstruksionit te kulmit, paisjeve dhe aksesoreve qe jari te rejare dhe te njejtat te deponohen ne ndonje depo te sigurte pasi qe munde te perdoret prap.Muret, shtyllat, trajet, pllakat betonarme, cokulla dhe themelet demolohet, ngarkohet dhe transportohet deri ne deponi ku e cakton investitori(jo me larg se 10 km nga punishtja).</u>	komplet	1.00	1,600.00	1,600.00
1.7	Demonitim-demolimi i objektit ndihmes ekzistues te klubit te futbollit "Vllaznimi".Objekti ka siperfaqe te bazes rreth 250m² dhe eshte njekatesh.Eshte relativisht i vjeter i ndërtuar me material jo shume te forte.Objekti eshte i mbuluar me salloni. <u>Verejtje: Duhet paraprakisht te behen demontimet e dverve, dritareve, mbuleses, konstruksionit te kulmit, paisjeve dhe aksesoreve qe munde munde te perdoret prap. Muret, shtyllat, trajet, pllakat betonarme, cokulla dhe themelet demolohet, ngarkohet dhe transportohet deri ne deponi ku e cakton investitori(jo me larg se 10 km nga punishtja).</u>	komplet	1.00	1,100.00	1,100.00
1.8	Demolime tjera te pa specifikuara me lart, si demolimi i instalimeve nentokesore dhe mbitokesore te cilat pengojne ndertimin e objektit te ri, demolimi i infrastruktures ekzistuese si rruge, staza, parkingje si dhe demolime tjera brenda hapësires ku do te behet ndertimi i ri. Te gjitha materialet e demoluara/mbeturinat te dergohen deri ne deponi legale. Çmimi te meret 20% nga pos 1.1 deri 1.8	%	0.20	3,700.00	740.00
1.9	Rrethimi i luallit për ndërtimin e objektit me konstruksion metalik dhe llamarinë të zinkuar me lartësi 2m në tërë perimetrin e caktuar të punishtës dhe shënjëzimi informativ me tabelën informuese me dimensione 1.5x2 m të punuar nga profilet e hekurit dhe llamarina.	m²	350.00	7.50	2,625.00

KOMISIONI I VLERESIMIT

1. DIAMANT HASI - *[Signature]*
2. BURIM BASHIRI - *[Signature]*
3. *[Signature]*

1.10	Furnizimi me material dhe ndërtimi i rrjetit të përkohshëm të ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit elektrik dhe ndriçimit të kantierit, vendosja e kontejnerit për zyrën e menaxhimit të projektit dhe njeve sanitare për punëtorë.	copë	1.00	450.00	450.00
1.11	Furnizimi me material dhe aplikimi i solucionit të lengshëm për largimin e ndryshkut në ankerat e mbetur të zbuluar tek një pjesë e themele të egzekutuar nga Operatori i mëshëm, Aplikimi i solucionit të lengshëm i posaqem për largimin e ndryshkut aplikohet me ane të brushes apo sperkaljes së armaturave të vjetra, si dhe pas kohës së caktuar së tharjes, të njetat armatura duhet të gerryhen me brushë teli qeliku, deri në largimin e ndryshkut	komplet	1.00	1,050.00	1,050.00
Gjithsej totali me TVSH					11,865.00
2	PUNËT E DHEUT/ZHAVORIT				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
2.1	Gërmimi i shiresës së humurit dhe dheut me trashësi 25 cm në tërë sipërfaqen e parapare për pozicionimin e Tribunes Perendimore. Në çmim duhet të përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km. Vërejtje: Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkurtësimit. Vërejtje: Një sasi e dheut duhet të mbetet në punishte për mbushjet eventuale dhe modelimin e oborrit.	m ³	575.00	3.40 €	1,955.00 €
2.2	Gërmimi i dheut me makineri deri në kuotën -60 cm lthellësi nga kuota e terrenit në tërë sipërfaqen e pozicionimit të Tribunes Perendimore. Në çmim duhet të përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km. Vërejtje: Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkurtësimit.	m ³	1,475.00	3.40 €	5,015.00 €
2.3	Gërmimi i dheut me makineri deri në kuotën -2.60 cm lthellësi nga kuota e terrenit për hapjen e shiritave për vendosjen e shpultave të themele të Tribunes Perendimore. Në çmim duhet të përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km. Vërejtje: Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkurtësimit.	m ³	2,650.00	3.20 €	8,480.00 €
2.4	Gërmimi i dheut me makineri deri në kuotën -2.60 cm lthellësi nga kuota e terrenit për hapjen e gropave për vendosjen e themeleve pllake të shkalleve dhe ashensoreve të Tribunes Perendimore. Në çmim duhet të përfshihet edhe transportimi i dheut të gërmuar deri në deponinë e përcaktuar nga autoritetet komunale në distancë deri 10 km. Vërejtje: Sasia e shënuar paraqet vëllimin e ngjeshur ku nuk është marrë parasysh koeficienti i shkurtësimit.	m ³	550.00	3.20 €	1,760.00 €
2.5	Ngjeshja i truallit në shiritat e gërmuar - niveli -2.60 nga niveli i terrenit me makineri vibruese (cilinder vibrues), deri në arritjen e kompaktësive min 25Mpa. E njëjta kompaktësi të dëshmohet me Elaboratin e rrezultateve të Ngjeshjes nga një Kompani e Licensuar	m ²	1,380.00	1.20 €	1,656.00 €
2.6	Ngjeshja i truallit në gropat e gërmuara për vendosjen e themele pllake të shkalleve dhe ashensorit në nivelin -2.60 nga niveli i terrenit, me makineri vibruese (cilinder vibrues), deri në arritjen e kompaktësive min 25Mpa. E njëjta kompaktësi të dëshmohet me Elaboratin e rrezultateve të Ngjeshjes nga një Kompani e Licensuar	m ²	380.00	1.20 €	456.00 €
2.7	Ngjeshja i truallit në sipërfaqen e pllakes së përdhese, në lthellësi të gërmuar -0.60 nga niveli i terrenit, me makineri vibruese (cilinder vibrues), deri në arritjen e kompaktësive min 25Mpa. E njëjta kompaktësi të dëshmohet me Elaboratin e rrezultateve të Ngjeshjes nga një Kompani e Licensuar	m ²	1,550.00	1.20 €	1,860.00 €
2.8	Ngjeshja i truallit rreth perimetrit të niveletit të përdhese të Tribunes Perendimore me një gjerësi mesatare 3.0m, në lthellësi të gërmuar -0.60 nga niveli i terrenit, me makineri vibruese (cilinder vibrues), deri në arritjen e kompaktësive min 25Mpa. E njëjta kompaktësi të dëshmohet me Elaboratin e rrezultateve të Ngjeshjes nga një Kompani e Licensuar	m ²	2,850.00	1.20 €	3,420.00 €
2.9	Furnizimi me material dhe punimi i tamponit nga zhavori me trashësi 120 cm me fraksion 0/400 në disa pjesë gjerësinë të kanaleve të hapura për stabilizim të terrenit duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në arritjen e kompaktësive Ms=50 MPa.	m ³	485.00	16.00 €	7,760.00 €

1. D.H. - *[Signature]*
2. B.B. - *[Signature]*
3. A.U. - *[Signature]*

2.10	Furnizimi me material dhe punimi i tamponit nga zhavori me trashësi 50 cm me fraksion 0/150 në disa pjesë gjerësinë të kanaleve të hapura për stabilizim të terrenit duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në arrijtjen e kompaktësisë Ms=50 MPa.	m ³	685,50	16,00 €	10,968.00 €
2.11	Furnizimi me material dhe punimi i tamponit nga zhavori me trashësi 30 cm me fraksion 0/63 në tërë gjerësinë e kanaleve të hapura nën themelet e veçura si dhe nën themelet pllake të shkalleve dhe ashensorit duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në arrijtjen e kompaktësisë Ms=50 MPa.	m ³	495,80	17,00 €	8,428.60 €
2.12	Furnizimi me material dhe punimi i tamponit nga zhavori me trashësi 25 cm me fraksion 0/63 në tërë sipërfaqen nën pllaken e nivelit 0.00/perdhese duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në arrijtjen e kompaktësisë Ms=50 MPa.	m ³	725.85	17,00 €	12,339.45 €
2.13	Furnizimi me material dhe punimi i tamponit nga zhavori me fraksion 0/63 mbi themelet e veçura duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen.	m ³	985.50	17,00 €	16,753.50 €
2.14	Furnizimi me material dhe punimi i tamponit nga zhavori me trashësi 10 cm me fraksion 0/31 në tërë gjerësinë e kanaleve të hapura nën themelet e veçura si dhe nën themelet pllake të shkalleve dhe ashensorit duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në arrijtjen e kompaktësisë Ms=50 MPa.	m ³	265.50	17,00 €	4,513.50 €
2.15	Furnizimi me material dhe punimi i tamponit nga zhavori me trashësi 10 cm me fraksion 0/31 në tërë sipërfaqen nën pllakën e nivelit 0.00/perdhese duke përfshirë edhe nivelimin dhe ngjeshjen me mekanizëm deri në arrijtjen e kompaktësisë Ms=50 MPa.	m ³	295.00	17,00 €	5,015.00 €
2.16	Pompimi i ujrave atmosferike apo nentokësore eventuale për largimin nga gropa ndërtimore, me ane të pompes atekuale	ore	100.00	5.00 €	500.00 €
Gjithsej totali me TVSH					90,880.05 €
3	PUNËT E BETONIT				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
3.1	Furnizimi me material, betonimi dhe vibrimi i po të njëjtit beton I klases C16/20-Beton I varfer , me trashësi mesatare prej 5cm, nën shputat e themeleve si dhe nën themelin pllake të shkalleve dhe ashensorit	m ³	78.00	75.00	5,850.00
3.2	Furnizimi me material dhe betonimi i themeleve të veçura, themeleve pllake të shkalleve dhe mureve anësore, me trashësi 80 cm me beton të markës c-35/45 me aditiv kristalor për padepërtueshmëri nga uji në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen të gjitha kallëpet e nevojshme.	m ³	595.00	115.00	68,425.00
3.3	Furnizimi me material dhe betonimi i kontratrajeve mbi themelet me beton të markës c-35/45 me aditiv kristalor për padepërtueshmëri nga uji në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Betonimi të bëhet deri në kuotën -20.0. Në çmim të përfshihen të gjitha kallëpet e nevojshme.	m ³	155.00	115.00	17,825.00
3.4	Furnizimi me material dhe betonimi i pllakës së meskallit në përdhese në kuotën ± 0.00. Pllaka me trashësi 20 cm betonohet me beton të markës c-35/45 me aditiv kristalor për padepërtueshmëri nga uji në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen të gjitha kallëpet e nevojshme.	m ³	548.00	115.00	63,020.00
3.5	Furnizimi me material dhe betonimi i shkallëve të stadiumit (kryesore dhe ato për evakuim emergjent) me beton të markës c-35/45 . Në çmim të përfshihen të gjitha kallëpet e nevojshme.	m ³	98.60	115.00	11,339.00
3.6	Furnizimi me material dhe betonimi i shkallëve dhe ashensoreve (berthames, 4 cope) me beton të markës c-35/45 me aditiv kristalor për padepërtueshmëri nga uji në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen të gjitha kallëpet e nevojshme.	m ³	325.00	115.00	37,375.00
3.7	Furnizimi me material dhe betonimi i shtyllave tribunave me dimensione 90x50 dh 315x50 me beton të markës c-35/45 me aditiv kristalor për padepërtueshmëri nga uji në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen të gjitha kallëpet e nevojshme.	m ³	218.50	115.00	25,127.50
3.8	Furnizimi me material dhe betonimi i trajeve të pjerrta/traut kryesor (konstruksionit primar të tribunave) me dimensione të ndryshme me beton të markës c-35/45 me aditiv kristalor për padepërtueshmëri nga uji në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen të gjitha kallëpet e nevojshme.	m ³	295.00	115.00	33,925.00

1. D. H. -

2. B. B. -

3. A. U. -

3.9	Furnizimi me material dhe betonimi i pllakave meskalëshe (kali 1 dhe kali 2 dhe 3) duke përfshirë trarë konstruktiv dhe krahë e shkallëve me beton të markës c-35/45 <u>Në çmim të përfshihen të gjitha kallëpet e nevojshme.</u>	m ³	1,387.50	115.00	159,562.50
3.10	Furnizimi me material dhe betonimi i pllakës së pjerrinës për persona me aftësi të kufizuara (kater cope) 20 cm me beton të markës c-35/45 me aditiv kristalor për padepërtueshmëri nga uji në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen të gjitha kallëpet e nevojshme.	m ³	32.40	115.00	3,726.00
3.11	Furnizimi me material dhe betonimi i cerklazheve shtanguese, trarëve mbi dyer dhe dritare me beton të markës c-25/30 Dimensionet e cerklazheve 25x25 cm dhe 12x25 cm. Në çmim të përfshihen të gjitha kallëpet e nevojshme.	m ³	28.40	115.00	3,266.00
3.12	Furnizimi me material dhe betonimi i mureve anësore me trashësi 50 cm, të gjithë mureve të parapeteve perimetrike të tribunave dhe parapeteve të shkallëve hyrese/dalese të tribunave me beton të markës c-35/45 me aditiv kristalor për padepërtueshmëri nga uji në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen të gjitha kallëpet e nevojshme.	m ³	119.50	115.00	13,742.50
3.13	Furnizimi me material dhe betonimi i pllakes meskalëshe të tribunave (pllakes se shkallezuar) duke përfshirë trarë konstruktiv me beton të markës c-35/45 me aditiv kristalor për padepërtueshmëri nga uji në masën 1 kg për çdo 100 kg të çimentos. Në çmim të përfshihen të gjitha kallëpet e nevojshme.	m ³	1,175.00	115.00	135,125.00
3.14	Furnizimi me material dhe instalimi i shiritit të fuges së dilatimit (Water Stop PVC Cold Expansion Joints in Concrete Structure) me gjërësi 25cm nga PVC në pjesën e dilatimit të tribunave tribunave në mes veti. Njëra anë e shiritit vendoset para fazës së betonimit të traut të tribunave. Pastaj vendoset ana tjetër në trautin tjetër.	m	45.00	30.00	1,350.00
3.15	Furnizimi me material dhe vendosja e shiritit ekspandues nga sodium bentoniti me dimensione 1.5x2.0 cm i cili në kontakt me ujin e zmadhon volumin nga 270% deri në 300% dhe përballon shypje deri në 5 atmosfere. Shiriti duhet të vendoset në mes të murit të bodrumeve dhe pllakës së themelit për sigurimin e padepërtueshmërisë së ujërave nëntokësore si dhe në çdo vazhdim të betonimit të mureve të bodrumit (niveli -70.0) dhe për mbylljen e depërtimeve të tubave në muret e bodrumit. Vendosja dhe vazhdimi i shiritave të bëhet sipas udhëzimeve të prodhuesit.	m	1,050.00	10.00	10,500.00
Gjithsej totali me TVSH					590,158.50
4 PUNËT E ARMATURËS					
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
4.1	Furnizimi me material dhe prerja, lakimi dhe lidhja e armaturës për formimin e elementeve sipas specifikimeve të armaturës me armaturë: Ø8 Ø10 Ø12 Ø14 Ø16 Ø20, Ø25, Ø28, Ø32 Q-335 rrjetë Q-524 rrjetë Armaturë për armim konstruktiv të arktrajeve dhe cerklazheve për shtangim dhe elementeve tjera me armim konstruktiv, 80kg/m ³ Të gjitha armaturat duhet të jenë të pastra nga korozioni. Në çmim të përfshihet edhe përdorimi i distancerave të llojeve të ndryshme në varësi të pozicionit me qëllim të arritjes së trashësisë së duhur të shtresës mbrojtëse.	kg	789,965.00	1.00	789,965.00
Gjithsej totali me TVSH					789,965.00
5 PUNËT E KONSTRUKSIONIT METALIK					
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
5.1	Furnizimi me material dhe montimi i trajeve të çelikut HEB240. Në çmim të parashifet edhe ngjyrosja në dy shtresa ngjyre antikoroziion dhe një shtresë ngjyre metalike nuance antracid	kg	12750.00	2.10 €	26,775.00 €
5.2	Furnizimi me material dhe montimi i pllakave lidhëse për trajet HEB240 në të dy anët. Dimensionet e pllakave lidhëse janë 400x400x20mm	kg	3350.00	2.45 €	8,207.50 €

1. D. H. - [Signature]
2. B. B. - [Signature]
3. A. H. - [Signature]

5.3	Furnizimi me material dhe montimi i pllakave lidhese ankeruese per trajet e mbuleses. Trashesia e pllakes ankeruese eshte 8mm e prera sipas detailit	kg	1250.00	2.45 €	3,062.50 €
5.4	Furnizimi dhe montimi i anker bulonave M20 per perforimin e trajeve HEB. Secila shtylle eshte e perforcuar ne te dy anet me nga 8M20 me gjatesi 30cm	cope	640.00	9.80 €	6,272.00 €
5.5	Furnizimi dhe montimi i anker bulonave M30 per lidhjen e shtyllave mbajtese te mbuleses metalike. Secila shtylle lidhet me 16M30 me gjatesi min 100cm	cope	320.00	11.80 €	3,776.00 €
Gjithsej totali me TVSH					48,093.00 €
6	PUNËT E MURATIMIT				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
6.1	Furnizimi me material dhe muratimi i mureve me trashësi 25cm, 20cm, 12 cm me blloqe të argjilës së pjekur, me llaç të fituar me përzierjen e rërës me lëndë lidhëse të gatshme në raport 3:1. Tek muret e brendshme duhet të punohet edhe çarklastrë shtangues në gjysmën e lartësisë.	m ³	415.90	129.00	53,651.10
Gjithsej totali me TVSH					53,651.10
7	PUNËT E SUVATIMIT				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
7.1	Furnizimi me material dhe suvatimi i mureve në të gjitha etazhat deri në nivelin e trarëve me material të parapërzier (gëlqerë+cimento+agregat) me trashësi 15 mm. Në çmim të përfshihet trajtimi paraprak i bazës me llaç sprucues, listelat metalike për caktimin e trashësisë së llaçit, këndoret metalike, listelat dilatuese (anputlesite) nga plastika me rrejtë armimi dhe shirit vetingjilës për dyer dhe dritare dhe mbrojtja e të gjitha pozicioneve të zbrukhtarisë me folie të PVC-së deri në finalizimin e suvatimit dhe ngjyrosjes së dritareve dhe PVC-së me fije qelqi për përforcimin e llaçit në çdo pjesë ku kalohet nga një material në tjetrin si blloqet-beton.	m ²	9579.00	7.60	72,800.40
7.3	Furnizimi me material dhe patinimi i mureve me dy shtresa gjet-masë (secila me trashësi së paku 1 mm).	m ²	9579.00	4.56	43,680.24
Gjithsej totali me TVSH					116,480.64
8	PUNËT E NGJYROSJES				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
8.1	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e pjeses së mureve me dy shtresa ngjyrë disperzive për enterier me bazë poliuretani dhe rezistencë të klasit 1 ndaj gërryerjes në të lagështi sipas DIN EN13300. Para ngjyrosjes duhet të bëhet trajtimi adekuat i sipërfaqes me bazë/primer për enterier për reduktimin e shkallës së absorbitimit të bazës, për përmirësimin e shkallës së ngjitjes, etj. Për më shumë të dhëna rreth ngjyrave dhe aplikimit të tyre shih përshkrimin teknik dhe broshurat e materialeve. Ngjyra duhet të ketë vullën e aprovimit nga TÜV për mostërimin e gazrave dhe substancave të dëmshme gjatë shfrytëzimit të mëvonshëm.	m ²	9579.00	3.00	28,737.00
Gjithsej totali me TVSH					28,737.00
9	PUNËT E NIVELIZIMIT				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
9.1	Furnizimi me material dhe punimi i nivelizimit me trashësi 6 cm në të gjitha kthinat e brendshme me dyshteme epokside duke përfshirë shtresën ndarëse nga folia e PVC-së dhe shiritin nga polietileni me trashësi 5 mm në kontakt me muret si në detaje për pengimin e përcjelljes së zërit struktural. Në çmim të përfshihet edhe armimi me rrejtë të tipit Q-188 Ø6/15.	m ²	217.00	27.00	5,859.00
9.2	Furnizimi me material dhe punimi i nivelizimit me trashësi 5 cm në të gjitha kthinat e brendshme me dyshteme qeramike duke përfshirë shtresën ndarëse nga folia e PVC-së dhe shiritin nga polietileni me trashësi 5 mm në kontakt me muret si në detaje për pengimin e përcjelljes së zërit struktural. Në çmim të përfshihet edhe armimi me rrejtë të tipit Q-188 Ø6/15.	m ²	1298.40	17.70	22,981.68

1. D.H. - [Signature]

2. B.B. - [Signature]

3. A.K. - [Signature]

9.3	Furnizimi me material dhe punimi i nivelizimit me trashësi deri 6 cm në pushimoret e shkallëve, rampa dhe në erëmbrojtësit e hyrjeve kryesore. Në çmim të përfshihet edhe armimi me rrjetë të tipit Q-188 Ø6/15.	m ²	450.00	10.50	4,725.00
Gjithsej totali me TVSH					33,565.68
10	PUNËT E HIDROIZOLIMIT				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
10.1	Furnizimi me material dhe hidroizolimi i kulmit të rrafshhtë të shfrytëzueshëm duke përfshirë edhe izolimin e cokllës në lartësi min.30 cm me shtresat si në vijim: • Iyerja bazë - primer bituminoz i aplikuar me brushë • hidroizolimi - me 2 membrana të përforcuara bituminoze 3 shresore me përbërje minerale, bitumeni dhe masat elastoplastomerike me rrjeta armimi. Trashësia e membranës min. 4 mm të ngjitura me flakë. Membranat duhet të kalojnë njëra mbi tjetrën min.10 cm Shih detalet "E&F" në faqet A-22 & A23.	m ²	205.00	9.40	1,927.00
10.2	Furnizimi me material dhe hidroizolimi me hidroizolim të lëngshëm i nyjeve sanitare duke përfshirë edhe hidroizolim të mureve deri në 30 cm lartësi ndërsa tek duhet deri në 200 cm lartësi, si dhe hidroizolimi i pozicioneve tjera të përcaktuara në detale si erëmbrojtës dhe shkallë të hyrjeve me hidroizolim të lëngshëm fleksibil dykomponentësh me bazë të polimerçimentos në dy shresa me trashësi nga 1 mm. Në çmim duhet të përfshihet edhe aplikimi i pëthurave të poliestarit ose rrjetave me fije qelqi në kënde për të penguar plasirijen e hidroizolimit si dhe sanimi paraprak i të metave të sipërfaqes me materiale adekuate me ngurtësim të shpejtë. Për më shumë informata rreth mënyrës së aplikimit të materialeve shih përshkrimin teknik dhe broshurat e bashkangjitura.	m ²	985.00	8.80	8,668.00
10.3	Furnizimi me material dhe hidroizolimi i strehëve dhe kulmëve të hyrjet kryesore me hidroizolim të lëngshëm si shtresë finale e ekspozuar me ngjyrë të bardhë. Për këtë duhet të përdoret hidroizolim elastomerik pa aplikimin e substancave tretëse shesë rezistente ndaj temperaturave prej -25C deri në +120C si dhe Iyerja paraprake e bazamentit me bazë/primer adekuat nga pakoja e të njëjtit prodhues. Hidroizolimi duhet të ketë aftësi të madhe të reflektimit të rrezeve të diellit mbi 85% dhe të jetë i çertifikuar me shenjë CE që plotëson kriterat për tu aplikuar si shtresë mbrojtëse për bazamente betoni sipas EN 1504-2. Në çmim duhet të përfshihet aplikimi i rrjetës nga fije të qelqit mbi shtresën e parë të hidroizolimit dhe më pas edhe dy shresa tjera hidroizolimi pasi të jenë respektuar afalet kohore për tharjen e nevojshme si dhe hidroizolimi i pjesëve vertikale dhe të pjerrëta sipas detaleve "S & T" në faqet A-35 & A-36. Për më shumë të dhëna rreth mënyrës së aplikimit shih përshkrimin teknik dhe broshurat e bashkangjitura.	m ²	185.00	9.80	1,813.00
Gjithsej totali me TVSH					12,408.00
11	PUNËT E MBULESES /ANKERIMET				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
11.1	Furnizimi me material dhe montimi i pllakave lidhëse ankeruese për trajet e mbuleses. Trashësia e pllakes ankeruese është 10mm e prera sipas detalit të pllakes mbajtëse të traut kryesor mbajtës.	kg	12850.00	0.88 €	11,308.00 €
11.2	Furnizimi dhe montimi i anker bulonave M32 për lidhjen e shtyllave mbajtëse të mbuleses metalike. Secila shtyllë lidhet me 16M32 me gjatësi min 100cm	cope	1600.00	7.60 €	12,160.00 €
11.3	Furnizimi dhe montimi i anker bulonave M24 për lidhjen e shtyllave mbajtëse të mbuleses metalike. Secila shtyllë lidhet me 8M24 me gjatësi min 100cm	cope	1160.00	1.40 €	1,624.00 €
Gjithsej totali me TVSH					25,092.00
12	PUNËT E DYSHEMESË				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
12.1	Furnizimi me material dhe punimi i dyshemesë epokside nga poliuretani, dyshemes epokside antistatike duke përfshirë edhe punimin e cokllës me listella këndore si dhe tharimin paraprak të bazës së estrihut me makinë gërryese dhe thithje të puhurit për eliminimin e shtresës së dobël që të mundësohet ngjitje sa më e mirë. Në çmim të përfshihet edhe mbushja e fugeve punuese me material adekuat si dhe sanimi i plasirijeve të bazës së estrihut.				

1. D. H. - [Signature]
2. B. B. - [Signature]
3. A. V. - [Signature]

12.6	Furnizimi me material, trajtimi dhe punimi i dyshemese se tribunave mureve anesore ne pjesene brendshme te tribunave me Sikafloor 400 N elastic. Paraparakishi dyshemeja duhet te pasirohet mire, te trajtohet me autonivelant, pastaj te aplikohen produktet Sikafloor 400 N elastic (ne tri shtresa) duke apikouar edhe shresat tjera te parapara nga prodhuesi Sika per keto lloje te punimeve si: Sikafloor 160, porzije me rore per mosrreshqilje, te arrihet shkalla P5 kunder rreshqiljes, per pjeset vertikale te trashet materiali me Skadur 513, per qoshe dhe nyje te perdoret Sikaflex Fillet dhe Sikaflex TANK elj. Sikafloor 400 N elastic eshte shume elastik, permban lreles, rezistent ndaj UV-se, lageshtise, reshjeve, papershkueshmrise nga uji, rezistent ndaj gerryerjeve te zakonshme. Materiali eshte i certifikuar sipas standardit EN 13813:2002 Verejtje. Te gjitha produktet e cekura me larte mund te zevendesohen me produkte tjera te cilesise se njejte dhe qe i plotesojne kushtet teknike te Klases R4 sipas Standardit EN 1504-03	m ²	4295.00	29.00	124,555.00
Gjithsej totali me TVSH					314,973.86
13	PUNËT E QERAMIKËS DHE GRANITIT				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
13.1	Furnizimi me material dhe mveshja e dyshemese se njeve sanitare me pllaka te paglazuar qeramike me dimensione 33x33cm, me ngjyre dhe lekturë te percaktuar nga organi mbikqyrës. Pllakat duhet te jene rezistente ndaj rreshqiljes min R12, rezistente ndaj ndryshimeve te temperaturës, rezistente ndaj ngricave, me shkallë te vogël te thihjes se lageshtise, rezistente ndaj abrazionit dhe te pershtatshme per frekuencim te madh me kerpucë ne ambiente publike, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijimit te njollave. Ngjitja e pllakave te behet me ngjites kualitativ fleksibil dhe hidroizolues me fuga te gjera 4 mm. Masa per mbushjen e fugave duhet te jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit. Në çmim te përfshihen listelat këndore nga alumini si dhe izolimi i fugave punuese me silikon sanitar rezistent ndaj mykut. Për më shumë informata shih përshkrimin teknik.	m ²	750.70	35.00	26,274.50
13.2	Furnizimi me material dhe mveshja e mureve te njeve sanitare dhe kthinave tjera ndihmese ne perdhese dhe kale me pllaka te glazuara qeramike me dimensione 25x40cm, me ngjyre dhe lekturë te percaktuar nga organi mbikqyrës. Pllakat per mure duhet te jene rezistente ndaj ndryshimeve te temperaturës, rezistente ndaj ngricave, me shkallë te vogël te thihjes se lageshtise, rezistente ndaj abrazionit, rezistente ndaj kemikaljeve dhe ndaj krijimit te njollave. Ngjitja e pllakave te behet me ngjites kualitativ fleksibil dhe hidroizolues me fuga te gjera 3 mm. Masa per mbushjen e fugave duhet te jetë kualitative, fleksibile dhe rezistente ndaj ujit. Në çmim te përfshihen listelat këndore nga alumini si dhe izolimi i fugave punuese me silikon sanitar rezistent ndaj mykut. Për më shumë informata shih përshkrimin teknik.	m ²	1536.00	35.00	53,760.00
13.3	Furnizimi me material dhe ngjitja e pllakave te granitit si pikore te dritareve, pllaka parapeti, pulle te recepcioneve etj. Pllakat duhet te ngjiten me ngjites adekuat per granit. Pikoret duhet te kenë te gdhendura kanalet per pengimin e rrjedhjes se ujit ne drejtimet e padëshiruara ne anën e poshtme si dhe paralelist me vijën e shpaletave. Në çmim te përfshihet edhe mbyllja e fugave me shiritë ekspandues hidroizolues per te parandaluar plasaritjen dhe demtimin e fasadës ndërsa ne enterier te perdoret edhe silikon sanitar. Pllakat e pikoreve duhet te mbështeten mbi mbajtës konzollë me ndërprerje termike te ankeruar ne çdo 50 cm. Për më shumë te dhëna shih përshkrimin teknik. Ngjyra dhe tekstura e pllakave te percaktohet nga organi mbikqyrës.				
a.	Pllaka te granitit me trashësi 2 cm dhe gjerësi 15 cm per pikoret e maseme te dritareve.	m ^l	248.00	44.00	10,912.00
b.	Pllaka te granitit me trashësi 2 cm dhe gjerësi 25 cm per pikoret e gjera te dritareve.	m ^l	122.00	19.50	2,379.00
c.	Pllaka te granitit me trashësi 2 cm dhe gjerësi 22 cm per parapetin e dritareve nga ana e brendeshme.	m ^l	370.00	19.50	7,215.00
d.	Pllaka te granitit me trashësi 3 cm dhe gjerësi 40 cm per pullet e recepcioneve. Secita brinjë te punohet nga një pllakë e velme ndërsa formimi i këndit te behet me prerje te pllakave ne 45°. Skajet e epërme te pllakave te prehen ne kënd.	m ^l	48.00	24.50	1,176.00

1. D. H. -

2. B. B. -

3. A. U. -

13.4	Furnizimi me material dhe mveshja e shkallëve të brendshme me pllaka graniti të poliruar Shkelëset - 35.0 x 145 cm dhe trashësi 3 cm Balloret - 12.8 x 145 cm dhe trashësi 2 cm Ngjitja të bëhet me llaç të çimentos me trashësi min.2 cm Basamakët që zbresin nga pushimoret të zgjaten në tërë gjatësinë e pushimoreve në vijë të drejtë. Në çmim të përfshihet edhe punimi i cokllës së shkallëzuar nga pllakat me lartësi 10 cm dhe trashësi 2 cm. Ngjyra dhe tekstura e pllakave të përcaktohet nga organi mbikqyrës.	copë	85.00	45.00	3,825.00
13.5	Furnizimi me material dhe mveshja e shkallëve të brendshme me pllaka graniti të poliruar Shkelëset - 35.0 x 215 cm dhe trashësi 3 cm Balloret - 12.8 x 215 cm dhe trashësi 2 cm Ngjitja të bëhet me llaç të çimentos me trashësi min.2 cm Basamakët që zbresin nga pushimoret të zgjaten në tërë gjatësinë e pushimoreve në vijë të drejtë. Në çmim të përfshihet edhe punimi i cokllës së shkallëzuar nga pllakat me lartësi 10 cm dhe trashësi 2 cm. Ngjyra dhe tekstura e pllakave të përcaktohet nga organi mbikqyrës.	copë	105.00	69.00	7,245.00
13.6	Furnizimi me material dhe mveshja e shkallëve të brendshme me pllaka graniti të poliruar Shkelëset - 35.0 x 245 cm dhe trashësi 3 cm Balloret - 12.8 x 245 cm dhe trashësi 2 cm Ngjitja të bëhet me llaç të çimentos me trashësi min.2 cm Basamakët që zbresin nga pushimoret të zgjaten në tërë gjatësinë e pushimoreve në vijë të drejtë. Në çmim të përfshihet edhe punimi i cokllës së shkallëzuar nga pllakat me lartësi 10 cm dhe trashësi 2 cm. Ngjyra dhe tekstura e pllakave të përcaktohet nga organi mbikqyrës.	copë	105.00	85.00	8,925.00
13.7	Furnizimi me material dhe mveshja e pushimoreve të shkallëve të brendshme dhe erëmbrojtësve të hyrjeve kryesore dhe hyrjes së personelit me pllaka graniti të poliruar me trashësi 2 cm duke përfshirë edhe punimin e cokllës nga pllakat me lartësi 10 cm dhe trashësi 2 cm. Ngjitja të bëhet me llaç të çimentos me trashësi min.2 cm. Ngjyra dhe tekstura e pllakave të përcaktohet nga organi mbikqyrës.	m ²	125.00	85.00	10,625.00
13.8	Furnizimi me material dhe mveshja e shkallëve të jashtme të hyrjet kryesore dhe hyrja e personelit me pllaka graniti me sipërfaqe të vrazhdë/të flakëruar. Shkelëset - gjerësi 35 cm dhe trashësi 3 cm Balloret - lartësi 12 cm dhe trashësi 2 cm Ngjitja të bëhet me llaç të çimentos me trashësi min.2 cm Në çmim të përfshihet edhe punimi i cokllës së shkallëzuar nga pllakat me lartësi 10 cm dhe trashësi 2 cm. Ngjyra dhe tekstura e pllakave të përcaktohet nga organi mbikqyrës.	m ²	65.00	85.00	5,525.00
13.9	Furnizimi me material dhe mveshja e pushimoreve të shkallëve të jashtme dhe dhe platosë para hyrjes së personelit me pllaka graniti me sipërfaqe të vrazhdë/të flakëruar me trashësi 2 cm. Ngjitja të bëhet me llaç të çimentos me trashësi min.2 cm. Ngjyra dhe tekstura e pllakave të përcaktohet nga organi mbikqyrës.	m ²	55.00	69.00	3,795.00
13.10	Furnizimi me material dhe mveshja e rampave/pjerrinave për personat me aftësi të kufizuara me pllaka graniti me sipërfaqe të vrazhdë/të flakëruar. Ngjitja të bëhet me llaç të çimentos me trashësi min.2 cm. Ngjyra dhe tekstura e pllakave të përcaktohet nga organi mbikqyrës.				
a.	Rampat - pllaka graniti 120x540 cm me trashësi 3 cm	m ²	19.50	74.00	1,443.00
b.	Mveshja anësore me pllaka graniti - trashësi 2 cm	m ²	5.50	69.00	379.50
13.11	Furnizimi me material dhe mveshja e kornizës rreth detyrve të ashensorit me pllaka graniti të poliruar me trashësi 2 cm. Gjerësia e kornizës 25 cm. Thellësia e mveshjes min.25 cm. Ngjitja të bëhet me ngjitës adekuat për pllaka graniti ndërsa fuga punuese në kontakt me dymet e ashensorit të mbushet me silikon sanitar. Ngjyra dhe tekstura e pllakave të përcaktohet nga organi mbikqyrës.	m ²	12.00	94.00	1,128.00
Gjithsej totali me TVSH					144,607.00
14	PUNËT E ZDRUKHTARISË				
Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH

1. D. H. - *[Signature]*

2. B. B. - *[Signature]*

3. A. H. - *[Signature]*

14.1	<p>Furnizimi dhe montimi i dritëreve dhe fasadës gjysëmstrukturalë shumëpjesëshe, me pjesë fikse dhe hapje "kiper". Materiali: ALUMIL ose prodhues i cilësisë së njëjtë. Sistemi: M6 Solar Standard me ndërprerje të urës termike dhe kapak për mbulimin e fugave. Profillet vertikale dhe horizontale: M10910 Kapaku: M9942 Listella e brendshme: M10914 Qelqi: Transparent/Termopan 6+14+4mm/Low-E + Argon Ngjyra: E hirtë - RAL 7016 Matt. Në çmim të përfshihen të gjitha elementet shitesë për evitimin e urës termike tek lidhja me fasadën termoizoluese. Dizajni sipas skemave të zdruktharisë.</p>				
a.	POS "AL1" 4 hapje "kiper" dhe 26 pjesë fikse. Dimensionet: 600x580 cm. Dizajni si në skemën e zdruktharisë	copë	8.00	4,280.00	34,240.00
b.	POS "AL2" 4 hapje "kiper" dhe 28 pjesë fikse. Dimensionet: 515x775 cm. Dizajni si në skemën e zdruktharisë	copë	8.00	4,280.00	34,240.00
c.	POS "AL3" 4 hapje "kiper" dhe 52 pjesë fikse. Dimensionet: 780x775 cm. Dizajni si në skemën e zdruktharisë	copë	3.00	5,050.00	15,150.00
d.	POS "AL4" 4 hapje "shiber" dhe 7 pjesë fikse. Dimensionet: 540x160 cm. Dizajni si në skemën e zdruktharisë	copë	3.00	2,200.00	6,600.00
f.	POS "AL7" 2 hapje "kiper" dhe 13 pjesë fikse. Dimensionet: 600x330 cm. Dizajni si në skemën e zdruktharisë	copë	1.00	2,200.00	2,200.00
g.	POS "AL8" 2 hapje "kiper" dhe 16 pjesë fikse. Dimensionet: 610x330 cm. Dizajni si në skemën e zdruktharisë	copë	1.00	2,200.00	2,200.00
h.	POS "AL9" 2 hapje "kiper" dhe derë njëkrahëshe dhe 5 pjesë fikse. Dimensionet: 365x330 cm. Dizajni si në skemën e zdruktharisë	copë	1.00	1,150.00	1,150.00
i.	POS "AL10" 1 hapje "kiper" dhe 5 pjesë fikse. Dimensionet: 260x330 cm. Dizajni si në skemën e zdruktharisë	copë	1.00	910.00	910.00
j.	POS "AL11" 1 hapje "kiper" dhe 8 pjesë fikse. Dimensionet: 470x330 cm. Dizajni si në skemën e zdruktharisë	copë	1.00	2,450.00	2,450.00
k.	POS "AL12" 2 hapje "kiper" dhe 28 pjesë fikse. Dimensionet: 1360x330 cm. Dizajni si në skemën e zdruktharisë	copë	1.00	5,500.00	5,500.00
l.	POS "AL13" 2 hapje "kiper" dhe 16 pjesë fikse. Dimensionet: 680x330 cm. Dizajni si në skemën e zdruktharisë	copë	1.00	2,450.00	2,450.00
m.	POS "AL14" 7 hapje "kiper" dhe 41 pjesë fikse. Dimensionet: 1700x330 cm. Dizajni si në skemën e zdruktharisë	copë	1.00	5,500.00	5,500.00
14.2	<p>Furnizimi dhe montimi i detyrës dhe dritëreve të jashtme sipas specifikimeve në projekt. Materiali: ALUMIL ose prodhues i cilësisë së njëjtë. Sistemi: M11600 Alutherm Extra, (identik me sistemin M11500) me ndërprerje të urës termike, shitesë termoizoluese nga poliamidet dhe 3 EPDM goma izoluese. Gjerësia e kornizës 76 mm ndërsa krahu 84 mm. Korniza fikse: M11514 Krahu i dritëres: M11934 Profill i mesëm "T": M11566 Profilli i mesëm lëvizës: M11658 Listella e kornizës: M11460 Listella e krahut: M11483 Krahu i derës: M11584 Adaptuesi i kahjes: M11662 Parapeti i derës: M11642 Qelqi: Transparent/Termopan 4+17+4mm/Low-E + Argon Dorëzat: Inox Ngjyra: E hirtë - RAL 7016 Matt. Të gjitha dritëret duhet të kenë nënshiresa çeliku 40x30x2 mm si dhe PVC profile si në vizatimet e zdruktharisë.</p>				
a.	POS AL15 - Dritare e kombinuar - 1 hapje(shiber) dhe 1 pjesë fikse Dimensionet: 240x160 cm. Dizajni si në skemën e zdruktharisë	copë	8.00	345.00	2,760.00
b.	POS D5 - Derë rrëshitëse. Dimensionet: 175x215 cm. Dizajni si në skemën e zdruktharisë	copë	1.00	745.00	745.00
c.	POS D6 - Derë rrëshitëse. Dimensionet: 270x215 cm. Dizajni si në skemën e zdruktharisë	copë	2.00	1,000.00	2,000.00

1. D. H. - *[Signature]*

2. B. B. - *[Signature]*

3. A. U. - *[Signature]*

d.	POS AL5- Derë dykrahëshe Kahu i hapjes së dverve: Jashtë Dimensionet: 180x240 cm. Dera duhet të ketë mbyllës hidraulik dhe shufër për hapje në shtylje "Panic bar". Dizajni si në skemën e zdrukthtarisë	copë	7.00	1,180.00	8,260.00
e.	POS AL6- Derë dykrahëshe Kahu i hapjes së dverve: Jashtë Dimensionet: 210x240 cm. Dera duhet të ketë mbyllës hidraulik dhe shufër për hapje në shtylje "Panic bar". Dizajni si në skemën e zdrukthtarisë	copë	13.00	1,180.00	15,340.00
f.	POS AL6 Derë dykrahëshe Kahu i hapjes së dverve: Jashtë Dimensionet: 160x240 cm. Dera duhet të ketë mbyllës hidraulik dhe shufër për hapje në shtylje "Panic bar". Dizajni si në skemën e zdrukthtarisë	copë	1.00	1,180.00	1,180.00
14.3	Furnizimi dhe montimi i dverve të brendshme të veshura me llamarinë çeliku. Materiali: HÖRMANN ose prodhues i cilësisë së njëjtë. Paneli: OIT - panel nga ashklat e drurit me trashësi 40 mm i veshur me llamarinë 0.8 mm. Korniza e derës: dy pjesëshe - profili 21180 me trashësi 1.5 mm (opcionale - profili teleskopik 21168) Profili i mesëm: çelik - tipi 41102 Dorëzat: Inox - tipi i levës me kapak në formë rozete Menteshat: tipi VX - 3 pjesësh me ngjyrë kromi mat Ngjyra: E bardhë - Traffic White RAL 7016.				
a.	POS D1 - Derë njëkrahëshe Dimensionet: 100x215 cm. Dizajni si në skemën e zdrukthtarisë	copë	35.00	300.00	10,500.00
b.	POS D2 - Derë njëkrahëshe Dimensionet: 90x205 cm. Dizajni si në skemën e zdrukthtarisë	copë	19.00	300.00	5,700.00
c.	POS D3 - Derë njëkrahëshe Dimensionet: 80x205 cm. Dizajni si në skemën e zdrukthtarisë	copë	5.00	300.00	1,500.00
d.	POS D7 - Derë njëkrahëshe Dimensionet: 90x205 cm. Dizajni si në skemën e zdrukthtarisë	copë	4.00	275.00	1,100.00
e.	POS D8 - Derë njëkrahëshe Dimensionet: 80x205 cm. Dizajni si në skemën e zdrukthtarisë	copë	6.00	345.00	2,070.00
f.	POS D4 - Derë njëkrahëshe e tualetit Dimensionet: 70x205 cm. Dizajni si në skemën e zdrukthtarisë	copë	6.00	325.00	1,950.00
g.	POS D9 - Derë njëkrahëshe e tualetit me hapje në dy anë për Handicap Dimensionet: 100x205 cm. Dizajni si në skemën e zdrukthtarisë	copë	5.00	345.00	1,725.00
14.4	Furnizimi dhe montimi i dverve të brendshme zjarrqëndruese të veshura me llamarinë çeliku. Materiali: HÖRMANN ose prodhues i cilësisë së njëjtë. Paneli: H16 OD - T90 Fire Proof Door, me mbushje nga leshti mineral - panel kompozit me trashësi 65 mm, i veshur me llamarinë çeliku 1.0 mm. Korniza e derës: dy pjesëshe e kombinuar nga llarina me trashësi 1.5 mm dhe e mbushur me lesht mineral. Izolimi Akustik: 44 dB. Dorëzat: Inox - tipi i levës me kapak në formë rozetash dhe profil për cilindër Menteshat: 3 pjesësh për pesha të mëdha, me ngjyrë kromi mat. Mbyllësi hidraulik dhe mekanizmi për hapje në rast rreziku "Panic Bar" Ngjyra: E bardhë - Grey White RAL 9002.				
a.	POS Z1 - Derë njëkrahëshe Dimensionet: 100x205 cm. Dizajni si në skemën e zdrukthtarisë	copë	5.00	770.00	3,850.00
